

VENDIM
Nr.1258, datë 16.12.2009

PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES SË GRANTIT, IDF, NR.TF 094711, NDËRMJET SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (IBRD), PËR PROJEKTIN “FUQIZIMI DHE VËNIA NË ZBATIM E KONVENTËS AARHUS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 7 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin, në parim, të marrëveshjes së grantit, IDF, nr.TF 094711, ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për projektin “Fuqizimi dhe vënia në zbatim e konventës Aarhus”, për shumën 370 000 (treqind e shtatëdhjetë mijë) USD, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha